

## MBI SIGURINË USHQIMORE

### Thirrje për Reagim dhe Integritet Institucional

Shëndeti i konsumatorëve shqiptarë dhe evropian mbetet prioritarë dhe lidhet pashmangshmërisht me garantimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që përmbushin standardet e cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Rasti i mandarinave me prezencë të clorpirifosit, i bërë publik në media, ka ngritur shqetësime mbi sfidat ekzistuese të sigurisë ushqimore dhe ka përforcuar nevojën për reagim të shpejtë dhe efektiv nga institucionet përgjegjëse. Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) dhe 37 organizatat anëtare të veta kërkojnë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), si dhe nga institucionet e tjera ligjzbatuese, një qasje transparente dhe të përgjegjshme për të adresuar situatën dhe për të forcuar besimin e publikut në sistemin e sigurisë ushqimore të vendit tonë.

Situata aktuale, por edhe probleme të tjera të mëhershme të tilla si lopët e infektuara me brucelozë, vaksinimet e porealizuara, falsifikimin e etiketimeve dhe ndryshimet ligjore për medikamentet, reflektojnë dobësi të theksuara të sektorit dhe nevojën e dukshme për përmirësimin e qeverisjes së sektorit bujqësor dhe rural. Në reagim të kësaj situatë, ANRD kërkon me këmbëngulje vëmendje aktive dhe reagim urgjent nga ana e institucioneve përgjegjëse në lidhje për sa më poshtë:

- Sigurimin e transparencës së plotë të veprimtarisë së institucioneve publike dhe informim publik mbi situatën, duke siguruar që ushqimet që konsumojmë janë të sigurta.
- Llogaridhënie institucionale dhe masa të menjëhershme për të adresuar situatën aktuale dhe parandaluar përsëritjen e rasteve të ngjashme në vazhdimësi.
- Forcimin e integritetit institucional në të gjitha nivelet e qeverisjes, nga niveli qendror deri në institucionet e varësisë dhe ligjzbatuese, si dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit në të gjitha fushat funksionale të MBZHR, me fokus të veçantë në sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit.
- Realizimin e konsultimeve publike të njëmendta dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e nismave ligjore dhe strategjike.

ANRD mbetet e angazhuar dhe përkushtuar për të monitoruar në vazhdimësi situatën dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në përmirësimin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve publike të qeverisjes së sektorit bujqësor dhe rural, duke përfshirë sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit.

**Mirëqenia e qytetarëve shqiptarë dhe evropianë është prioritet. Garantimi i sigurisë ushqimore është çështje e panegociueshme!**

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural  
Agjencia e Zhvillimit Rajonal Lezhë  
AGRIEN Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore (AGRIEN)  
Agrinas Ersekë  
Shoqata GVV “Kolonja e Gjelbër”  
AgriNet Albania  
AGROPUKA  
Bashkëpunimi për Zhvillimin e Vendeve në Emergjencë (COSPE)  
Creative Bussiness Solutions (CBS)  
Diakonia Agapes  
Dorcas Aid International Albania (DAI Albania)  
Federata Bujqesore Elbasan  
Fondacioni CESVI Onlus (CESVI)  
Grate ne Bujqesine e Qendrueshme (WSA)  
Help Shqiperi  
Instituti i Bujqësisë Biologjike (IBB)  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)  
Instituti për Paqe, Zhvillim dhe Inovacion (ACLI-IPSIA)  
Klubi i Sipërmarrësve të Rinj (KSR)  
Kordinimi i Organizatave për Shërbim Vullnetar (COSV)  
Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore  
Programi për Mbështetjen e Shoqatave Rurale (RASP)  
Qendra Agritra-Vizion  
Qendra e Rinisë Rurale (RYH)  
Qendra Konsumatori Shqiptar  
Qendra për Zhvillim dhe Integrim (CDI)  
Shoqata "Integrimi" Tropojë  
Shoqata “Aleanca Alpeve Shqiptare”  
Shoqata e Përdoruesve të Burimeve Natyrore Velçan  
Shoqata GVV “Mokër-Gorë”  
Shoqata e Zhvillimit Bujqesor te Rretheve Malore (ADAD Malore)  
Shoqata Ishmi  
Shoqata mjedisore “Çajupi”  
Shoqata për Integrimin Gjinator (FGIA)  
Shoqata GVV “Pro Përmet”  
Vizion i Gjelbër  
Volontari nel Mondo (RTM)  
Vullnetarizmi Ndërkombëtar për Zhvillimin (VIS Albania)  
World Vision Albania

